



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1711/ 6 Prot.,

Datë 24.06.2026

V E N D I M
Nr. 856 / 2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.06.2026 me

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe “Marketing & Distribution” ShPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me NIPT K81503063B, Adresa: Rr. “Faik Konica”, ndërtesa nr.3, hyrja nr.7, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë. Adresa: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë–Durrës, Km. 10, Rr. Iliria, nr. 53, Kashar, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 24.04.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 11.05.2026 ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe në përfundim të vlerësimit të ofertave në SPE, me dt.25.05.2026 ka kryer renditjen si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi
1. InfoSoft Office ShPK	1,077,000	Skualifikuar anomalisht e ulët
2. IT Gjergji Kompjuter ShPk	1,141,000	Skualifikuar anomalisht e ulët
3. MARKETING & DISTRIBUTION ShPK	1.220.000	Skualifikuar anomalisht e ulët
4. LIBRARI DYRRAHU ShPK	1,690,000	Kualifikuar

II.3 Nga verifikimet e kryera në SPE, Autoriteti Kontraktor më datë 26.05.2026 ka publikuar Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6742, datë 01.06.2026 dhe me Nr. 1711/2026 Prot., datë 01.06.2026, nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe “Marketing & Distribution” ShPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formularin e Publikimit nr. 1711/1 prot., datë 02.06.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorët ekonomikë si vijon:

- “IT Gjergji Kompjuter” ShPK është skualifikuar:

“Referuar Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin nr. 710, datë 24.11.2021, ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 01.08.2024, ndryshuar me Vendimin 545, datë 04.09.2024), Neni 82, pika 4, si edhe referuar ligjit nr. 16/2024, datë 08.02.2024, neni 93, pika 5, oferta është anomalisht e ulët pasi vlera e saj është më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, konkretisht është 84.4976%.”

- “Marketing & Distribution” ShPK është skualifikuar:

“Referuar Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin nr. 710, datë 24.11.2021, ndryshuar me Vendimin nr. 498, datë 01.08.2024, ndryshuar me Vendimin 545, datë 04.09.2024), Neni 82, pika 4, oferta është anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë 25% e fondit limit të përllogaritur, konkretisht oferta është ulur 33.5 %.”

Nga llogaritja e 85% të mesatares së ofertave të vlefshme ZM DEL: 1,089,700.00 LEKË. Referuar rregullave të prokurimit publik cdo ofertë e ofertuar me vlerë më të ulët se vlera prej 1,089,700.00 lekë, është një ofertë anomalisht e ulët dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar, duhet të skualifikohet menjëherë pa kërkuar shpjegime, pasi procedura e prokurimit është me vlerë nën kufijtë e martë monetare. Nga përllogaritjet rezulton se oferta e OE nfoSoft Office rezulton anomalisht e ulët. Kërkojme shfuqizimin e Vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertave të “IT Gjergji

Kompjuter” ShPK dhe “Marketing & Distribution” ShPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar pasi nuk rezultojnë në vlera anomalisht të ulta.

II.6. Me shkresën ardhur në Sistem me date 11.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1711/2, datë 11.06.2026, si edhe shkresa ardhur me shërbim postar me nr. 874/9 prot., datë 11.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1711/3, datë 15.06.2026, me anë të së cilës ka përcjellë vendimin e KSHA-së mbi shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë me argumenta në mënyrë të përmbledhur si vijon:

[...]→ Në lidhje me pretendimin e OE: ...Parimet e mësipërme të përcaktuara në nenin 2 të LPP-së si dhe qëllimet e ligjit 162/2020, të ndryshuar, të përcaktuara në nenin 3 të tij, janë shkelur në mënyrë të hapur nga KVO-ja e autoritetit kontraktor, duke cënuar në mënyrë të padrejtë interesat e shoqërisë tonë duke na s’kualifikuar nga kjo procedurë prokurimi në shkelje të rregullave të prokurimit publik, sqarojmë se AK ka vepruar në përputhje të parashikimeve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike. ...

*Ne perfundim të shqyrtimit të dokumenteve të OE ofertues, AK konstatoi se të gjithë OE plotesonin kriteret e vendosura por rezultoi se oferta e renditur e para ishte anomalisht e ulët. **KVO mori masa për refuzimin e ofertes së OE InfoSoft Office. Tashmë në SPE janë vetëm tre oferta të vlefshme rrjedhimisht vet sistemi i Prokurimeve Elektronike konstaton se oferta e IT Gjergji Kopjuter është anomalisht e ulët.***

Përsa me sipër KVO u gjend në situatë kur vet sistemi i prokurimeve elektronike konstaton se ofertat e 3 OE janë anomalisht të ulëta....

Të gjithë OE pjesëmarrës janë trajtuar në mënyrë të barabartë në llogaritjen e ofertës anomalisht të ulët, e cila bëhet automatikisht në SPE, AK ka aplikuar formulë për tre operatore mbetur në garë. Gjithashtu gjejmë të pabazuar pretendimin se edhe në DT përcaktohet qartë që aplikimi i ofertës anomalisht të ulët bëhet vetëm një herë se përlllogaritja kryhet vetëm njëherë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në përfundim të sa më sipër:

VENDOSI

Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” shpk, në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar”, me objekt “Blerje kancelari”, me nr. REF-83122-04-23-2026.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me anë të së cilës kundërshton vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, argumentuar si vijon:

“SË PARI: Oferta e dorëzuar nga shoqëria IT Gjergji Kompjuter SHPK, me vlerë të ofertuar 1,141,000 (një milion e njëqind e dyzetë e një mijë) lekë pa TVSH është skualifikuar nga KVO-ja në autoritetin kontraktor si një ofertë anomalisht e ulët, e konkretisht është argumentuar si më poshtë vijon: ..

Referuar VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, nenit 82, pika 4, si dhe referuar ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, i ndryshuar, neni 93, pika 5, oferta është anomalish e ulët pasi vlera e saj është më e vogël se 85%e mesatares së ofertave të vleshme, konkretisht 84.4976%... Arsyeja e mësipërme për skualifikim nuk qëndron, është në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe si e tillë kjo arsye për skualifikim e dhënë nga KVO-ja duhet të shfuqizohet

Nga llogaritja e 85% të mesatares së ofertave të vlefshme ZM DEL: 1,089,700.00 LEKË. Referuar rregullave të prokurimit publik cdo ofertë e ofertuar me vlerë më të ulët se vlera prej 1,089,700.00 lekë, është një ofertë anomalisht e ulët dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të ligjit Nr. 162/2020 Për prokurimin publik i ndryshuar, duhet të skualifikohet menjëherë pa kërkuar shpjegime, pasi procedura e prokurimit është me vlerë nën kufijtë e martë monetare.

Në rastin konkret vetëm oferta e dorëzuar nga InfoSoft Office SHPK, me vlerë të ofertuar 1,077,000 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, është më e ulët se zbritja e lejuar, pra se vlera 1,089,700.00 LEKË dhe si e tillë kjo ofertë me të drejtë është skualifikuar nga KVO-ja.

KVO ka gabuar duke skualifikuar edhe ofertën e praqitur nga shoqëria jonë pasi oferta e dorëzuar nga ana jonë në këtë procedurë prokurimi në vlerën 1,141,000 (një milion e njëqind e dyzetë e një mijë) lekë pa TVSH, është më e lartë se vlera që del nga përlllogaritja e formulës, pra se vlera 1,089,700.00 LEKË. KVO ka përlllogaritur gabim formulën sipas pikës 4 të Nenit 82 (Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave) të VKM 285/2021. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik , i ndryshuar, në lidhje me verifikimin nëse cmimet e ofertave të ofertuesve të kualifikuar janë apo jo anomalisht të ulëta...

KVO-ja ka interpretuar dhe zbatuar sërish gabim dispozitat ligjore si më sipër, pasi referuar arsyes për skualifikim të dhënë nga KVO-ja ajo dukshëm ka aplikuar formulën për verifikimin e ofertave nëse janë apo jo anomalisht të ulëta 2 herë.

Kërkojme shfuqizimin e Vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertave të “IT Gjergji Kompjuter” ShPK dhe “Marketing & Distribution” ShPK, në procedurën e prokurimit sipërcituar pasi nuk rezultojnë në vlera anomalisht të ulta.

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

III.1.2. Në nenin 82/4 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: $O - \text{Oferta MO} - \text{Mesatarja e ofertave të vlefshme}$ $N - \text{Numri i ofertave të vlefshme}$ $PR (Zm) - \text{Zbritje e mundshme}$ $MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$ $PR = 85 \% Mo$ ***Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.***

III.1.3. Në Kreun II, “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë

milione) lekë; **b)** Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.1.4. Referuar Dokumenteve Standarde të Procedurës së Prokurimit, Vlerësimi i Ofertave, citohet:

Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuar < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose

nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

III.1.5. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që, *ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.*

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se operatorët ekonomikë janë njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO, i cili nga shqyrtimin i arsyeve të skualifikimit në procedurë konstaton, se AK ka kryer vlerësim duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë të sukseshëm në përmbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit

Referuar Vlerësimit të ofertave ekonomike në SPE rezulton, se pas aplikimit formulës për përlogaritjet e ofertave anomalisht të ulëta, Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë “InfoSoft Office” ShPK, “IT Gjergji Kompjuter” ShPk dhe “MARKETING & DISTRIBUTION” ShPK të cilat sipas Informacionit të KSHA-së, cituar më sipër në pikën II.6. ku referon mbi vlerësimin dhe skualifikimet e operatorëve ekonomikë me oferta në vlera anomalisht të ulëta rezultojnë si vijon:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertave	Vlerësimi i KVO-së
1. InfoSoft Office ShPK	1,077,000	Skualifikuar anomalisht e ulët
2. IT Gjergji Kompjuter ShPk	1,141,000	Skualifikuar anomalisht e ulët
3. MARKETING & DISTRIBUTION ShPK	1,220,000	Skualifikuar anomalisht e ulët
4. LIBRARI DYRRAHU ShPK	1,690,000	Kualifikuar

III.1.6. Komisioni nga shqyrtimi i ankesës, i vendimit të KSHA-së dhe dokumenteve të dosjes administrative vëren se, referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së se: *në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët*”, procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, Mallra, me fond limit 1.834.527,⁴⁹ Lekë pa TVSh, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, rezulton me vlerë të fondit limit nën kufirin e lartë monetar, referuar VKM-së Nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”.

Referuar Informacionit të AK-së, në lidhje me vlerësimin ofertave të cilat në aplikim të formulës, mbi vlerësimin e një oferte anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më

shumë oferta të vlefshme, rezultuan anomalisht të ulëta, në referim të nenit 93 të LPP-së i ndryshuar shtuar pika: **(5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.)**, Autoriteti kontraktor ka skualifikuar tre ofertat sipër cituara për vlera anomalisht të ulëta.

Nga shqyrtimi i ankesës, Komisioni vëren se operatori ekonomik ngre pretendime: [...] mbi shfuqizimin e Vendimit të KVO-se për skualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPk dhe “MARKETING & DISTRIBUTION” ShPK si edhe duke theksuar se KVO nuk ka zbatuar Ligjin dhe VKM, të ndryshuara, mbi ofertat anomalisht të ulëta, sikurse edhe në DT përcaktohet qartë që aplikimi i ofertës anomalisht të ulët bëhet vetëm një herë dhe mbi ofertat që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të vlefshme. AK ka aplikuar dy herë formulën perkatese [...]

Komisioni, referuar fakteve, kreu hetim administrativ dhe konstatoi, se procedura e prokurimit objekt ankimi është Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, me fond limit nën kufirin e ulët monetar referuar dosjes së tenderit në seksionin “të dhënat kryesore” autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës, çfarë do të thotë që mbi këtë parashikim verifikohet nga organet e shqyrtimit të ofertave dhe më tej hapat që duhet të ndiqen nga autoritetet kontraktore në rastin e konstatimit të ofertave anomalisht të ulëta, referuar kreut II të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”.

Komisioni për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm, në referim të pretendimeve të ankimuesit, mori në shqyrtim vlerësimin e ofertave në lidhje me aplikimin e formulës perkatese, për operatorët ekonomikë të mbetur në garë pas vlerësimit të tyre në përmbushje të Kriteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kualifikimit. Referuar raportit të auditit konstatohet se pas vlerësimit në përmbushje të kriteve të kualifikimit janë kualifikuar 4 (katër) operatorët ekonomikë ofertes. Në aplikim të formulës perkatese, kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta, rezulton si më poshtë:

Mesatarja e 4 Ofertave të vlefshme: $1,077,000 + 1,141,000 + 1,220,000 + 1,690,000 = 5,128,000 / 4 = 1,282,000 \times 85\% = 1,089,700$, dhe ofertat nën këtë vlerë do të vlerësohen si anomalisht të ulëta, duke sjellë konkretisht skualifikimin nga gara të operatorit ekonomik InfoSoft Office ShPK me oferte në vlerë **1,077,000 Lek** pa tvsh.

Për sa analizuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ofertat e operatorëve ekonomikë “IT Gjergji Kompjuter” ShPk dhe “MARKETING & DISTRIBUTION” ShPK nuk rezultojnë me vlera anomalisht të ulëta, sikurse Autoriteti Kontraktor i ka trajtuar si të tilla me Vendimin e KVO-së.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon se Vendimi i KVO-së nuk është i drejtë dhe Autoriteti Kontraktor duhet të shfuqizojë atë. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertave sipas konstatimeve të mësipërme duke ndjekur hapat proceduralë në përputhje me Ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë Vendimin e KVO-së dhe të rivlerësojë ofertat në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Ngarkohet zyra e financës që të kthejë tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik IT Gjergji Kompjuter” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

